



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr**

**Dt: 20.03.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 , nenit 8, 9,10 dhe 13. e të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe Përfundimit Nr. 06-12830-13/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt. 12.02.2015, më të cilin është miratuar kërkesa e gazetarit Fahri Musliu për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për botimin e monografisë kushtuar aktorit Bekim Fehmiu, me dt: 20.03.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Fondacionit “Bekim Fehmiu” e ushtruar nga drejtori ekzekutiv i këtij Fondacioni z. Fahri Musliu e evidentuar me nr. 10-400-8708 e dt. 29.01.2015, për ndihmë financiare për botimin e monografisë kushtuar artistit me famë botërore Bekim Fehmiu, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,000.00€.

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Fondacionit “Bekim Fehmiu” nr. 1502031001859967, Raiffsen Bank.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**CO:** - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

- Z. Fahri Musliu, drejtor ekzekutiv i Fondacionit “Bekim Fehmiu” në Prizren, rr. “J. Gervalla”

- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**